

| Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe I |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
|--------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                           | Tipi                                                                                                                                                                                          | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| ALB 101                        | A                                                                                                                                                                                             | Vjeshtë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 4.00                | 0.00                | 0.00           | 4.00    | 5.00 |
|                                |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                        |                                                                                                                                                                                               | Brikena Smajli, PhD                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                      |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                 |                                                                                                                                                                                               | Anglisht                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                |                                                                                                                                                                                               | Bachelor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                     |                                                                                                                                                                                               | Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm. |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                     |                                                                                                                                                                                               | •Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit. •Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore. •Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjëritimit normativ. •Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). •Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore             |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës              |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| Java                           | Tema                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 1                              | Gjuha shqipe në një vështrim të përgjithshëm: -origjina dhe emri -dokumentet e para -dialektet - alfabeti -shqipja letrare                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 2                              | Leksiku i shqipes: Fjalori - Llojet e fjalorëve - Ç'është fjalori shpjegues dhe si përdoret ai?                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 3                              | Semantika - Kuptimi i fjalëve - Fusha leksikore dhe kuptimore - Sinonimet, antonimet, homonimet - Shprehjet frazeologjike                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 4                              | Fjalët e huaja në gjuhën shqipe - Neologjizmat - Huazimet dhe llojet e tyre                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 5                              | Burimet e pasurimit të gjuhës shqipe - Shqipërimi i disa fjalëve dhe prapashtesave të huaja - Ndërkombëtarizmat dhe terminologjitë e fushave të ndryshme.                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 6                              | Normat e shqipes standard - Shprehitë e të shkruarit drejt - Karakteristikat e gjuhës standard - Ilustrime me shembuj të shtypit të shkruar (gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore)          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 7                              | GJINIA, TRAJTA DHE RASA E EMRIT - Ndërrimi i gjinisë së shumësit të emrave mashkullorë - Emra me temë të njëjtë në të dyja gjinitë - Trajta dhe rasa e emrit - Përdorimi i emrave të përveçëm |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 8                              | Provim gjysmëfinal (MIDTERM). Çështje sintaksore. Rendi i gjymtyrëve në fjali                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 9                              | Përemri - Përemri vetor - Trajtat e shkurtra të përbëra - Drejtshkrimi i trajtave të përbëra - Sintaksa e përemrit vetorë Gabimet në përdorimet e trajtave të shkurtra                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 10                             | Rendi i gjymtyrëve në fjali - Rendi i përcaktorëve të një emri - Përshtatja e gjymtyrëve në fjali - Përshtatja e kohëve në periudhën me nënrenditje                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 11                             | Fjalitë e përbëra me bashkërenditje Llojet, ndërtimet.                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |
| 12                             | Fjalitë e përbëra me nënrenditje: - Përcaktore - Ftilluese - Kohore - Qëllimore - Vendore - Shkakore - Rrjedhimore - Lejore - Kushtore - Krahore - Mënyrore - Sasiore                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                     |                     |                |         |      |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                      |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>13</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Rastet jonormative të përdorimit të foljeve - Roli i pikësimit në organizimin e mendimit -Parimet e pikësimit                                                        |
| <b>14</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Klasifikimi i shenjave të pikësimit - Përdorime të veçanta të shenjave të pikësimit - Pikësimi në fjalinë e thjeshtë - Pikësimi i periudhës dhe paragrafëve të gjatë |
| <b>15</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Përsëritje. Ushtrime                                                                                                                                                 |
| <b>16</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Provim Final                                                                                                                                                         |
| <b>Parakushtet</b> Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                      |
| <b>Literatura</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës).</li> <li>• Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002.</li> <li>• Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004.</li> </ul> |                                                                                                                                                                      |
| <b>Referenca të tjera</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006.</li> <li>• Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Tiranë: shtëpia botues "Shkenca", 1999</li> <li>• Robert Elsie, Historia e Letërsisë shqiptare.</li> <li>• Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU, 1988, f. 247-276.</li> </ul>                             |                                                                                                                                                                      |
| <b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                      |
| <b>1</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të gjuhës dhe do të dinë të shkruajnë pa gabime drejtshkrimore.                                                            |
| <b>2</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Studentët do të mund të përkthejnë më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur në mënyrë rrënjësore gjuhën amtare.                                    |
| <b>3</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Studentët do të arrijnë të shkruajnë ese, njoftime, deklarata etj., në mënyrë koherente dhe të saktë.                                                                |

| <b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>                                                     |              |                          |                              |
|------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|--------------------------|------------------------------|
| <b>Notat e Ndërmjetme</b>                                                                | <b>Sasia</b> | <b>Përqindja</b>         |                              |
| Gjysmë finale                                                                            | 1            | 20                       |                              |
| Kuize                                                                                    | 2            | 10                       |                              |
| Projekte                                                                                 | 0            | 0                        |                              |
| Projekte semestrale                                                                      | 0            | 0                        |                              |
| Punë laborator                                                                           | 0            | 0                        |                              |
| Pjesëmarrja në mësim                                                                     | 1            | 10                       |                              |
| <b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>                            |              |                          | <b>40</b>                    |
| <b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>                                  |              |                          | <b>60</b>                    |
| <b>Total</b>                                                                             |              |                          | <b>100</b>                   |
| <b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>                                 |              |                          |                              |
| <b>Aktivitetet</b>                                                                       | <b>Sasia</b> | <b>Kohëzgjatja (orë)</b> | <b>Ngarkesa Totale (orë)</b> |
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16           | 4                        | 64                           |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)                              | 14           | 3                        | 42                           |
| Detyra                                                                                   | 0            | 0                        | 0                            |
| Gjysmë finale                                                                            | 1            | 10                       | 10                           |
| Provimi final                                                                            | 1            | 14                       | 14                           |
| Të tjera                                                                                 | 1            | 5                        | 5                            |
| <b>Ngarkesa totale e orëve</b>                                                           |              |                          | <b>135</b>                   |
| <b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>                                                |              |                          | <b>5.40</b>                  |
| <b>ECTS</b>                                                                              |              |                          | <b>5.00</b>                  |